



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS	
KOSOVO DOCTORS CHAMBER	
LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Mjekë:	ZK
Unitë:	Nr. Prot.:
Jedinica:	Prot. No.:
Nr. i faqeve:	129/2019
No. of pages:	Br. Prot.:
Bn. stranice:	Data:
-02-	Date:
	Datum:
05.02.2019	
Praktikimi	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF. 129/2019

- PËR:** Udhëheqësve të Institucioneve Shëndetësore Private në Republikën e Kosovës
- NGA:** Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci, Kryetar, Oda e Mjekëve të Kosovës
- CC:** Dr. Ardita Baraku – Kryeinspektore –Inspektorati Shëndetësor, MSH
Departamentit i Shërbimeve Shëndetësore
- LËNDA:** Qarkore njoftuese lidhur me anëtarësinë, kuotën e anëtarësisë dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare të mjekëve të huaj të punësuar pranë institucioneve shëndetësore private
- Datë:** 05 shkurt 2019

Të nderuar,

Anëtarësimi në OMK është obligativ për të gjithë doktorët e mjekësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës, përfshirë këtu edhe mjekët e huaj që ushtrojnë profesionin e mjekut brenda territorit të Republikës së Kosovës të cilët obligohen të njohin dhe zbatojn Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore të Kosovës si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë shërbimin shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Meqënëse një numër i madh i mjekëve të huaj që ushtrojnë veprimtarinë e tyre mjekësore pranë institucioneve të cilat Ju i udhëhiqni nuk janë anëtarësuar ende pranë OMK-së, ju njoftojmë se ndaj tyre do të fillohet procedura e hetimit pranë organit gjegjës të OMK-së, i cili ka te drejtë te shqiptojë gjobën ndëshkuese për çdo muaj në shumë prej 30 euro, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm në procedurë përmbarimore.

Si rrjedhojë e kësaj, çdo ushtrim i veprimit të mjekësore nga mjekët e huaj të cilët nuk janë të anëtarësuar dhe nuk i kryejnë detyrimet e tyre ndaj OMK-së siq është pagesa e kuotës së anëtarësisë, është në kundërshtim me ligjin dhe si pasojë mund të bëhen edhe objekt i hetimit nga Inspektorati Shëndetësor pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe poashtu objekt i hetimit nga organet e institucioneve të drejtësisë të Republikës së Kosovës.

Andaj, luteni që ti informoni të gjithë të punësuarit shtetas të huaj pranë institucionit të cilin e udhëhiqni, se të njejtë nuk mund të ushtrojnë veprimit të tyre mjekësore pa qenë anëtar të OMK-së, të cilat janë të obliguar që menjëherë pas pranimit të kësaj qarkoreje të paraqiten pranë zyreve të OMK-së që të kryejnë procedurat për anëtarësim në Odë.

Çështja tjetër për të cilën duam të ju njoftojmë përmes kësaj qarkoreje njoftuese është edhe çështja e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe lëshimit të dokumenteve(shkresave) mjekësore në gjuhët zyrtare nga mjekët e huaj gjatë ushtrimit të veprimtarisë mjekësore pranë institacioneve tuaja.

Jemi dëshmitarë të lëshimeve të dokumenteve të shumta mjekësore si raporte, udhëzime, përshkrim i terapive mjekësore për pacientët nga mjekët e huaj që ushtronjë veprimtarinë mjekësore pranë institucioneve private shëndetësore, e poashtu komunikim i drejtpërdrejtë me pacientët pa prezencën e përkthyesit të licencuar, e që ne si OMK e vlerësojmë si shqetësues këtë fakt duke pas parasysh faktin se shkelen të drejtat e pacientit për informim të drejtë dhe të kuptueshmë sipas Nenit 29 të Kodit Etik të Deontologjisë Mjekësore. Kjo nënkupton që pas çdo vizite apo trajtimi pacienti ka të drejtë në qasjen në dokumentacione mjekësore në njëren nga dy gjuhët zyrtare të përcaktuara me ligj e që janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe.

Përdorimi i gjuhëve zyrtare në sferën private sipas Nenit 29 paragrafi 29.1 dhe 29.2 të Ligjit Nr.02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare, e ka rregulluar kuartë komunikimin ndërmjet palëve e që në lëminë e shëndetësisë i referohen si komunikim mjekë-pacient. Poashtu e drejta e pacientit/ qytetarit për të qenë i informuar gjatë vizitës dhe trajtimeve mjekësore është e garantuar edhe me Ligjin Nr.2004/38 Për Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, përkatesisht Neni 9 me paragrafët 9.5 dhe 9.6 ku flitet për të drejtën për të qenë i informuar.

Si rrjedhojë e kësaj, obligoheni që në rastet e ofrimit të shërbimeve mjekësore nga mjekët e huaj të cilët ushtronjë veprimtarinë mjekësore pranë institucionit tuaj, të siguroni që të njejtët kanë komunikim me pacientët sipas gjuhës të cilën e kuption pacienti, që janë dy gjuhët zyrtare në Rep. e Kosovës dhe poashtu çdo dokument i lëshuar të jetë në gjuhën shqipe apo serbe të përcaktuara si gjuhë zyrtare. Në të kundërt OMK do të inicoj hetime për të gjithë mjekët e huaj që shkelin Ligjin për OPSH-të, Statutin e OMK-së, Kodin e Deontologjisë Mjekësore si dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Vërejtje: Për çdo gjetje të shkeljeve të përcaktuara sipas legjislacionit të OMK-së dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, OMK do ta njoftoj Inspektoratin Shëndetësorë pranë MSH-së. Keni parasysh që edhe ju si institucione shëndetësore private bartni përgjegjësi me rastin e shkeljeve ligjore të mundshme nga mjekët e huaj, të punësuar pranë institacioneve tuaja!

Prishtinë, 05 shkurt 2019

Kryetari i OMK-së
Dr. Plenat Sejdiu, Mr.Sc

